



01/Nr. 2025/2024
Data : 11.03.2024

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e dytë -II- për vitin 2024 e Komitetit për Politikë dhe financa, mbajtur me datë 20.02.2024 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsime Kulturë, Rini dhe Sport), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoresh për Kulturë Rini dhe Sport), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Ajete Berisha** (Udhëheqëse e Personelit), **Sevime Bajrami** (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve të NPL "Pastrimi"), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2023.
3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023.
4. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të gjashtë parcelave kadastrale.
5. Raporti financiar për vitin 2023 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
6. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- te diskutimi i imë ku përmendet fjalia kulmet të plotësohet kulmet të cilat janë të mbuluara me pllaka të azbestit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- krahas aktiviteteve të përditëshme dhe takimeve të Kryetarit janë arritur disa marrëveshje dhe janë bërë subvencionime apo iniciativa që janë ndërmarr për herë të parë në komunën tonë. Ndër marrëveshjet e bashkpunimit janë marrëveshjet Marrëveshje me MMPHI për Projekti "Rregullimi i hapësirave publike dhe zgjerimi i rrugëve afër zonës kufitare". Memorandum Mirëkuptimi me organizatën Humanity First Kosova për familje në nevojë me pako me produkte ushqimore për festën e Kurban Bajramit. Marrëveshje në kuadër të projektit TAKE në Fushën e Arsimit. Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Komunës së Hanit të Elezit dhe Organizatës Qatar Charity – Kosova për pako ushqimore gjatë muajit Ramazan dhe Kurban Bajramit. Bashkëpunim me kompaninë IPKO për vendosjen e sistemit të sofistikuar të ultrazërit. Marrëveshje bashkëpunimi me Agjencionin për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për realizimin e projektit "Ekzodi Bllaca 99 - faza e dytë" . Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për realizimin e aktiviteteve kulturore për nder të bashkëatdhetarëve tanë në diasporë. Marrëveshje bashkëpunimi me Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse - BIRN Kosova, lidhur me auditimin social për projektin "Rregullimi i parkut Isa Berisha". Marrëveshje bashkëfinancimi me Relief Islamic Kosova në fushën e Shëndetësisë për rekrutimin e tre mjekëve, një laboranti teknik, 3 infermierëve dhe 1 shoferi, ku Komuna bashkëfinancon në shumë rreth 40 mijë € për dy vite. Marrëveshje bashkëfinancimi me Relief Islamic Kosova në fushën e Bujqësisë për subvencionimin e fermerëve me serra me dimensione 5 x 20 m , ku Komuna dhe përfituesit kanë participuar me shumë mbi 30 mijë € . Marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë për Zhvillim Rajonal - Lindje për realizimin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal dhe rajonal. Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e Pensionerëve të TKM / FSK dhe Simpatizantëve "ELITA". Marrëveshje me Zyrën e Bashkimit Evropian për projektin e IPA Fondeve në shumë mbi 728 mijë € për një sistem inteligjent për zbulimin e hershëm të përmbajtjeve dhe monitorimin e mbetjeve në pellgun e lumit Lepenc. Memorandum mirëkuptimi me Open Data Kosova për përfshirjen e komunës në platformën Akterët Lokalë. Marrëveshje me 6 përfituesit/et e projektit "Komuna për të Rinjtë - M4Y" - faza e dytë , me subvencionim prej 1,767 €. Marrëveshje mirëkuptimi me SPITALIT SPECIAL PËR REHABILITIM TË PËRGJITHSHËM "BANJA E KLLOKOTIT" SH.P.K për rehabilitimin e shoqatës së pensionerëve, shoqatën Handikos dhe familjet e dëshmorëve. Marrëveshje me Kontigjentin Italian dhe Polak të KFOR-it për dhurimin e defibratorëve, shtretërve dhe dollapëve për çerdhen. Nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- te zyra e prokurimit shënon shtimi i kapaciteteve të ujit në fshatin Dimcë por nuk e kuptoj se për çfarë shtimi të kapaciteteve bëhet fjalë . Te drejtoria e administratës kërkoj sqarim për çështje të derivateve dhe kilometrave. Te drejtoria e Financave buxheti është paraqitur se buxheti është në shumë 3,349,715.00 € , ndërsa buxheti përfundimtarë është në shumë prej 3,453,882.26 €, ndërsa në faqe tridhjetë e tre buxheti është 4,252,808.11 € që mendoj që nuk është i qartë dhe më intereson sa a ka suficit në këtë pjesë. Në faqe tridhjetë e pesë nuk e kuptojë tabelarin e planifikimeve 560,121.00 €, të hyrat direkte 358,141.65 € . Te urbanizmi te projekti Bllaca 99 sa mjete financiare janë të komunës që janë investuar atje.

Sevdi Dernjani thekson:- për shifrat të sakta janë edhe marrëveshjet dhe te projekti Bllaca 99 janë 30 000 €.

Arsim Dernjani thekson:- është bërë trajtimi i bazenit në fshatin Dimcë dhe në fshatin Gorancë nga vendi i quajtur Sodonecë është bërë ndërrimi i gypit të ujësllësit deri te bazeni.

Natyra Kalisi thekson:- sa i përket shpenzimit të karburanteve për automjetet zyrtare është numri në bazë të faturimit dhe raporti nga komisioni i cili i pranon faturimet.

Lindita Ballazhi thekson:- në bazë të ligjit të buxhetit të Republikës së Kosovës buxheti për komunën e Hanit të Elezit është në shumë prej 3,349,715.00 € pastaj kemi bërë alokimin e bilancit të pa shpenzuar që ishte shuma prej 125,257.43 €. Po ashtu kemi pranuar donacionin nga IPA fondet në shumë prej 446 000 € dhe pjesë e buxhetit është shuma prej 114.08 € që përfshihen disa grantet të mbetura prej viteve të kaluara. Alokimi i donacionit nga Qeveria Japoneze në shumë prej 43,809.40 €, si dhe pjesa tjetër është shtesë nga Qeveria me hyrje në fuqi të ligjit të ri të pagave 284,575.32 €, Buxheti përfundimtarë i komunës është në shumë prej 4,252,808.11 €. Projektioni i të hyrave për vitin 2023 ishte në vlerë prej 560,121.00 € dhe prej këtij projektioni kemi realizuar 358,141.65 €, ndërsa të hyrat finale për vitin 2023 janë në shumë prej 421,872.82 €. Nuk mundet të llogaritet suficit një e hyrë e cila nuk është inkasuar dhe ne i kemi realizuar 64 % të të hyrave dhe pjesa tjetër që nuk është realizuar nuk është suficit. Prej grantit qeveritarë mjete të pa shpenzuara janë në shumë 65466.93 €.

Sherif Berisha thekson:- nuk po mundem me kuptuar se a janë orëmatësit për shtimin e kapaciteteve të ujit. A është uji i pishëm nëpër gypat tonë që furnizohemi. Ka vërejtje te faturimi, personalisht mu më a ardhur fatura ujit një euro , ndërsa dikujt 35 € , dikujt 50 €. Çka duhet të bëjmë me këtë ujë që nuk është i pishëm.

Sevdi Dernjani thekson:- drejtori i dha përgjigjet por unë mendoj që kjo pyetje ka të bëjë më shumë te pika te të ndryshme për shkak se është raporti për vitin 2023.

Hyriete Isufi thekson:- te plani i personelit për vitin 2023 parashikonte 22 pozita të lira, që prej tyre 12 janë shpallur dhe janë rekrutuar , dy pozita janë shpallur por nuk kanë mundur të realizohen sepse kanë dështuar për arsye të mungesës së kandidatëve. Kërkoj sqarim se për cilën pozitë bëhet fjalë që nuk ka pasur kandidatë. Gjashtë pozita të lira në sektorin e arsimit nuk janë shpallur fare procedurat e rekrutimit.

Ajete Berisha thekson:- dy pozita kanë qenë në fund të vitit 2022 dhe kanë dalë edhe në planin e vitit 2023 dhe janë të përfunduara, ndërsa dy të tjerat janë që janë përfunduar gjatë vitit 2023. Gjashtë pozitat tjera kanë qenë të planifikuara por nuk kanë mundur të realizohen se brenda këtij viti ka ndodhur që kemi pasur pushime të lehonisë dhe janë zëvendësuar me rastet që kanë ardhur pa planifikim. Bëhet fjalë për në shërbim civil që në lëvizje paralel nuk ka pasur konkurs të brendshëm dhe të njëjtat procedura janë shpallur me pranim nga jashtë dhe janë realizuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të gjashtë parcelave kadastrale.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- kemi të bëjmë me gjashtë parcele të pronave private për te rruga që shkon te parku Bllaca 99 . Katër parcela janë në pronësi të Gurit Bekuar, një parcelë është në emër të Mevludin Zelfi Kuka dhe një parcelë është në emër të z.Xhemshi Luri.

Kryesuesi thekson:- këtu nuk kuptojë asgjë me numra të parcelave dhe mendoj që materiali nuk është i plotësuar është mirë që me ja bashkangjitur ortofotot sepse ju si drejtor e dini por ne nuk e dimë saktë për ku bëhet fjalë.

Nexhmedin Daci thekson:- secila parcelë e ka numrin, sipërfaqen dhe pronarin por për mbledhje të kuvendit ja bashkangjesë edhe ortofotot.

Sherif Berisha thekson:- për mbledhje të kuvendit ne të plotësohet edhe me material shtesë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHHËM TË GJASHTË PARCELAVE KADASTRALE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5.Raporti financiar për vitin 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevime Bajrami thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:- e kemi mbajtur një takim me Komisionin e Aksionarëve dhe me përfaqësuesit e N.P.L Pastrimi sh.a dhe kemi diskutuar për çështjen e pagesës për komisionin e aksionarëve për shkak se me Ligj ju takon.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINACIARË PËR VITIN 2023 NPL PASTRIMI SH.A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- Ligji i vjetër ka skaduar në mujin shtatorë të vitit 2022 ndërsa ligji i ri në muajin korrik 2023 Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin e ri për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 06L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe ky Ligj ka hyrë në fuqi nga muaji shtatorë i vitit të kaluar. Ndryshimi më i madh i ligjit është se e ka zgjatur afatin deri në vitin 2025 . vitin e kaluar nga muaji shtatorë i kemi pasur tri aplikime. Kuvendi ka marr vendim që nga taksë e legalizimit lirohen nga pagesa kategoritë e dalura nga lufta.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI PROCESIN E TRAJTIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE DHE LEGALIZIMIN E TYRE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- te zytari për shëndetësi a është e vërtetë që mungojnë mjetet financiare nga të hyrave në shumë prej 1700 € deri në 1900 €. Më intereson diferencimi drejtori me drejtori në mes vete dhe te zytarë në tërësi. Keni vendosur me i dërguar materialet e forta në fshatin Gorancë por nuk e di se në çfarë Ligji jeni bazuar.

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- mjetet financiare nuk mungojnë , gjithçka është me raportim dhe është në rregull dhe përkundrazi në këtë vit ka pasur rritje të të hyrave.

Sevdi Dernjani thekson:-për pyetjen që e parashtrove lidhur me diferencimin mund të ja parashtroni Kryetarit të Komunës në mbledhje të Kuvendit.

Nexhmedin Daci thekson:- e kemi obligim ligjorë me pasur deponi për mjetet e ngurta dhe jemi përcaktuar në vendin e quajtur Zheden por procedurat sa i kemi filluar dhe marrin kohë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:11.

Procesmbajtësja
Sara Berisha



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

